

**P. nr.842/13**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA THEMELORE NË PEJË,D.P , gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurve R.L., J. N., B. N. dhe M. N. ,sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr. 1235/13 të dt. 04.11.201, për shkak të veprës penale të kryer në bashkëveprim : Vjedhje e Pyllit nga neni 358 par 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së , dhe për të pandehurin R. L. për veprën penale: të vjedhjes së pyllit nga neni 358 par 2 e të KPRK-së , pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik dhe me gojë të mbajtur në praninë e të pandehurve R. L , J. N, B. N , M. N. dhe mbrojtësit të të pandehurit M. N av. S. L. dhe të prokurorit të shtetit Lumturije Hoxha me dt.17.6.2015 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë:

## **A K T G J Y K I M**

### **I. PJESA LIRUESE**

#### **Të pandehurit:**

**1. R. L, i lindur me dt. në fsh. Sh. K. e P , tani me vendbanim në P rruga A.J, i biri i T. dhe nënës B. e gjinisë R, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.**

**2 J. N. i lindur me dt.. në Sh i M .K e P , biri i J. dhe i nënës Gj. e gjinisë G, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.**

**3. B. N.i lindur me dt. në fsh. Sh i M. K e P, ku edhe tani jeton, i biri J. i dhe i nënës Gj. e gjinisë G. , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.**

**4. M. N. i lindur me dt. në fsh. Sh. i M. K e P, ku edhe tani jeton, i biri i A. dhe nënës S. e gjinisë Z., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri**

**Konform nenit 364 par 1 pika 1.3 të KPRK-së**

### **LIROHEN NGA AKTAKUZA**

#### **Gjëja se :**

Me dt. 22.6.2013 rreth orës 23:00 në pyllin e mbrojtur të vendi i quajtur “Podi i Jakupit” Rajoni Ekonomiko Pyjor “Rusolia” Komuna e Pejës dhe në kundërshtim me ligjin numër 04/L-086 për parkun Komblltar “Bjeshkët e Nemuna” në bashkëveprim dhe me qëllim vjedhje kanë bërë prerjen e 16 ( gjashtëmbëdhjetë) trunqeve të llojit “Breu” me vëllim të përgjithshëm prej 30,401 m3 , duke shkaktuar dëm material në shumë prej 4,560 euro, në atë mënyrë që ditën kritike të pandehurit me sharrë motorike kanë prerë trunqe të cekura më lartë , e pastaj të njëjtat i kanë ngarkuar në traktor dhe kamion të llojit Man pronë e të pandehurit Rexhep, mirëpo që hasen nga ana e pylltarit, i cili pastaj ka bërë konstatimin e vendit të prerjes dhe dëmit të shkaktuar.

-me çka në bashkëveprim kishin për kryer veprën penale : të vjedhjes së pyllit nga neni 358 par 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së .

sepse nuk u provua se të pandehurit e kanë kryer veprën penale me të cilën ngarkohen.

Shpenzimet procedurale ju ngarkohen mjeteve buxhetore të gjykatës.

## **II. PJESA DËNUESE**

**I pandehurit R. L. me të dhëna personale si në pikën I të dispozitivit ,**

### **ËSHTË FAJTOR**

Për shkak se :

Me dt. 13.6.2013 rreth orës 12:00, në pyllin e mbrojtur, pikërisht te vendi i quajtur “Bojoviq” fsh. Shtupeq Komuna e Pejës dhe në kundërshtim me ligjin numër 04/L -086 për parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” ka bërë prerjen e 10 (dhjetë) trungjeve të llojit “Breu” me vëllim të përgjithshëm prej 3,01m<sup>3</sup> duke i shkaktuar APK-së në Pejë dëmin material në shumë prej 451 euro, në atë mënyrë që ditën kritike i pandehuri me sharrë motorike ka prerë trungjet e cekura më lartë, pastaj të njëjtat i ka ngarkuar në kamionin e tij të llojit “Man” me targa regjistrimi ----- , me ç’ rast duke i transportuar pikërisht te vendi i quajtur “te Dulia” në Pejë është hasur nga ana e policisë të cilët i konfiskojnë trungjet e lartcekura.

-me çka ka kryer veprë penale : të vjedhjes së pyllit nga neni 358 par 2 të KPRK-së .

Prandaj gjykata të pandehurin konform nenit 41, 42,46, 49, 50,51,52, 85, 86 dhe nenit 358 par 2 të KPRK-së.

### **E GJYKON**

1. **Me dënim me gjobë , në lartësi prej 100 euro , të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj jo më vonë se 60 ditë pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.**

Nëse i pandehuri dënimin në fjalë nuk e paguan me kohë i këtij do të shndërrohet në dënim burgu duke llogaritur 20 euro= 1 ditë burg!

2. **Gjyqtari , po ashtu të pandehurit R. L. SHQIPTON :**

### **DËNIM TË KUSHTËZUAR**

Në atë mënyrë që ia përcakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 ( gjashtë ) muaj , e të cilin dënim i pandehuri fare nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

I pandehuri për shkak të gjendjes së varfër ekonomike lirohet nga pagimi i paushallit gjyqësorë .

E dëmtuara për realizimin eventual të kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzime procedurale nuk ka pasur .

### **A r s y e t i m**

PTH në Pejë kundër të pandehurve R. L., J. N , B. N dhe M. N., ka ngritë aktakuzë me numër dhe datë si në hyrje, për shkak të veprës penale: vjedhje e pyllit nga neni 358 par 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, kurse për të pandehurin R. L. për veprë penale të vjedhjes së pyllit nga neni 358 par 2 të KPRK-së të

KPK- së , duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor të pandehurit ti shpall fajtor, ti dënoi sipas ligjit dhe ti obligoi në pagimin e shpenzimeve procedurale.

Në shqyrtimin gjyqësorë të pandehurit pasi që paraprakisht janë njoftuar me të drejtat dhe obligimet procedurale , me aktakuzën dhe mundësinë e deklarimit përkitazi me fajësinë – nuk e kanë pranuar fajësinë, për çka gjyqtari e ka bërë nxjerrjen e provave me ç rast është dëgjuar pylltari i APK-së Rr.B dhe janë lexuar dhe shikuar : shkresa e dt. 26.6.2013 në emër të R. T, L e Drejtorisë për Bujqësi , Pylltari dhe Hidro ekonom, kërkesa për ngritjen e procedurës për demin pyjor për të pandehurin R. L pa datë, raporti i oficerit Sh. B.i i dt. 13.6.2013, deklarata e të pandehurit R. L dhënë në polici me dt. 13.6.2013, vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve i dt.13.6.2013 , fotografit bardh e zi : dy të pjesës së përparme të automjetit – të kamionit Man ----- dhe tri të tjera të trungjeve – 10 copë të ngarkuar në te, raporti lidhur me prerjen ilegale në Shtupeqin e Vogël –Podi i Jakupit e dt. 22.6.2013, 10 faqe të fotografive bardh e zi të vendit të prerjes – cunat dhe vendi përreth, janë lexuar dhe shikuar shkresat tjera të lëndës , dhe në fund është dëgjuar mbrojtja e të pandehurve.

Me këtë rast gjatë procedurës së të provuarit është thënë:

### **Dëshmitarit- pylltari Rr. B ka deklaruar :**

Sa i përket pikës I të aktakuzës që ka të bëjë me datë 13.6.2013 unë nuk di asgjë sepse siç u pa edhe nga aktakuza për dt. 13.6.2013 ku akuzohet i pandehuri R. L trungjet në fjalë i ka hasur dhe i ka konfiskuar policia .Sa i përket pikës II të aktakuzës që ka të bëjë me të katër të pandehurit me 22.6.2013 unë mund të them se : në ora 20:00 mua me ka thirre Muhamet Shoshi udhëheqës i APK-së dhe me ka thënë “ merri 2-3 vet dhe eja me dal në vend të ngjarjes në filon vend” unë i thirra disa koleg por nuk më erdhën . Meqenëse nuk ka pas veturë zyrtare kam dal me veturë time dhe nga Peja kamë shkuar drejtë tek Maja e Zezë kapur me Podin e Jakupit. Aty e kam takuar kamionin e tipit Man me ngjyrë bojë qielli me ceradë i ngarkuar “rrafsh me stranica” . kam tentuar me e fotografua nuk kam mujt – **nuk me ka punuar fotoaparati** . tek kamioni kanë qenë të katër të pandehurit . Plus ka pas edhe tjerë trupa të shkarkuar në tokë , ka qenë edhe një traktor dhe atë vetëm koka e traktorit , aty ka qenë edhe një kalë , jam nis me shkua në vendin e ngjarjes , nuk kam pas bateri e kamë lënë për në mëngjes . Kur jam kthyer i kam lut të pandehurit që ti lenë trupat aty , këta kanë thanë se do ti lemë trupat aty , por kur kam ardh herët në mëngjes bashkë me I. L nuk kam gjet aty asnjë trup. Pastaj kemi shkuar në vendin e prerjes - 600 metra larg vendit ku i takova një natë më parë , e kemi matur vendin –cunat dhe i kemi fotografuar cunat . Gjithçka ishte e qartë se aty ishin prerë .Trupat në fjalë nuk di ku i kanë dërguar të pandehurit. Përndryshe në Rugovë rrallë ka ndodhë që “ mos me ndigu pala” . **Ne jemi të obliguar që në raste të tilla ta thërrasim policin vetëm kur pala nuk dëgjon** .Në kamion atë natë kanë qenë 14 trupa , në tokë kanë qenë 12 trupa . Nuk e di se i kujt është kamioni por vozitës ka qenë i pandehuri R .Trupi i prerë mbi 6 metra i gjatë nuk ka mundësi reale që të bartet nga vendi i prerjes pa lënë gjurmë të zhagitjes . **Mbrëmjen kritike ne nuk e kemi bërë matjen e trupave në kamion dhe afër tij** .Ata kanë qenë të njëjtës masë, unë në kamion një natë më parë i kamë shikuar trungjet mirë , dhe prandaj të nesërmen jam bind se ata janë prerë në vendin ku unë e thashë më parë. **Atë mbrëmje ka pas hanë**. Atë mbrëmje unë asnjërin prej të pandehurve nuk i kamë parë duke prerë dru , por i kamë parë duke ngarkuar . nuk e di a kanë qenë drutë e të pandehurve por këta kanë qenë duke u marr me to. **Të pandehurit i kamë njohur edhe më parë që të gjithë dhe asnjëherë problem me asnjërin prej tyre nuk kam pas** .

Duke i lexuar shkresat e lëndës të përmendura më lartë është konstatuar :

Nga kërkesa për ngritjen e procedurës penale të dt. 04.7.2013 të ushtruar nga drejtoria për bujqësi , pylltarit dhe hidro ekonomi për disa lëndën në pikën 6 dhe 10 të saj përmendet emri i të pandehurit R. L., nga një shënim i të njëjtës drejtori përcaktohen të dhënat për të njëjtin të pandehur dhe specifikohet sasia masës drunore të prerë nga i njëjti i pandehur, nga raporti i oficerit Sh. B dt. 13.6.2013 konstatohet se me

dt. 13.6.2013 është hasur nga policia automjeti me targa ----- pronë e B. N ... të ngarkuara me 12 copë trup të bredhit pa dokumentacion përkatës me ç ‘rast automjeti dhe trupat janë konfiskuar , duke lexuar deklaratën e të pandehurit R. L të dhënë në polici me dt. 13.6.2013 del konstatimi se i njëjti ka deklaruar se trungjet e prera të dt. 13.6.2013 i ka prerë në pronën private ... nga vërtetimin mbi konfiskimin e sendeve të dt. 13.6.2013 konstatohet se atë mbrëmje janë ndaluar dhe konfiskuar : një kamion “Man, 10 copë druje teknik dhe një CRA me numër 0437582” , duke shikuar 3 faqe të fotografive bardh e zi vërehet automjeti “ Man” me targa ----- dhe 10 trungje të ngarkuara ne te, pastaj në fotografitë tjera po ashtu bardh e zi shihen disa trungje të rrëzuara dhe cungje të trupave të prerë ,.

### **Të pandehurit në mbrojtjen e tyre kanë deklaruar :**

#### **I pandehuri R. L. :**

Për sa i përket veprës penale për dt. 13.6.2013 e pranoj se me ka zënë policia me 10 trungje dhe se unë këto trungje i kamë prerë në malin tim privat dhe jo në malin e shtetit për arsye se jam i gjendjes së varfër ekonomike dhe kam pas për qëllim që të siguroj të ardhura për mbajtjen e familjes . Trungjet me janë konfiskuar . Për sa i përket veprës penale të dt. 22.6.2013 unë nuk kam lidhje me këtë punë dhe mbrojtjen kritike fare nuk kam qenë atje . Nuk është e vërtet se pylltari B kinse na ka takuar duke ngarkuar trungje në kamion . Atë natë unë kamë qenë në shtëpi dhe fare nuk kamë qenë në atë vend . përndryshe pylltari do të na fotografonte pa asnjë dyshim . Unë siç thash më lartë e pranova se verën e dt. 13.6.2013 e kamë kryer – por prerjen e kamë bërë në pyllin tim privat - prandaj po ta kisha bërë do ta pranoja edhe veprën e dytë. E pat edhe vet se dëshmitari B. para jush tha se asnjëherë më mare me mua por as me të akuzuarit tjerë nuk e ka pas as më të voglin problem , edhe artë që e kamë thënë në polici që sot e lexuar këtu është e njëjta . Në raste të tilla pylltarët domosdo fotografojnë personat , automjetet dhe lëndën e prerë – siç e keni rastin e parë timin ku i pat fotografit e kamionit dhe të trungjeve të ngarkuar në te, prandaj unë nuk e kamë kryer këtë vepër penale bashkë me të pandehurit tjetër - atë të dt.22.6.2013.

#### **I pandehuri J. N. :**

Nuk e kam kryer veprën penale me të cilën akuzohem. Nuk kam lidhje me këtë çështje. Atë mbrëmje duket të kem qenë në vendin e punës- ujë Rugove ku jam i punësuar . Nuk është e vërtet se na ka takuar pylltari B. duke ngarkuar trungje në kamion. Ai edhe vet tha se “ nuk i ka punuar aparati” në raste të tilla siç e tha edhe i pandehuri R. ata gjithmonë fotografojnë, prandaj nuk është e vërtet se atë mbrëmje unë kam qenë vendin e cekur më lartë duke ngarkuar trupa në kamion. Kurrë më parë nuk kamë qenë i paraqitur e as i dënuar për diçka të ngjashme .

#### **I pandehuri B. N. :**

Nuk është e vërtet se me dt. 22.6.2013 dëshmitari B. na ka zënë duke ngarkuar trupa në kamion . Atë mbrëmje unë me siguri kam qenë në shtëpi . Unë kurrë në jetë nuk jam marrë me këto punë këtë e tha më parë edhe dëshmitari B . të pandehurit tjerë i njoh por me këtë çështje nuk kemi lidhje .Unë jam befasuar shumë për akuzën që më është bërë. Nuk e di për çfarë arsye pylltari me ka paraqitur mua për këtë punë .

#### **I pandehuri M. N. :**

Nuk është e vërtet se mbrëmjen kritike kamë qenë në vendin si në aktakuzë . pylltari nuk me ka takuar dhe nuk me ka parë fare . atë mbrëmje unë kam qenë në shtëpi- kështu mendoj edhe pse nuk si ta di me siguri këtë punë por në vendin ku thotë dëshmitari B. unë nuk kamë qenë. E pat edhe vet s dëshmitari B.tha “ nuk i ka punuar fotoaparati” si mund ti besohet dikujt vetëm me fjalë?. Asgjë personale nuk kam pas kurrë me pylltarin B. – këtë e tha edhe ai personalisht , prandaj jam i befasuar shumë dhe i indinjuar për këtë aktakuzë. Me parë nuk kamë qenë i dënuar për vepra të tilla apo të ngjashme .

**Në fjalën përfundimtare palët kanë deklaruar :**

**Prokurori i shtetit Lumturije Hoxha :**

Në tërësi mbetem pranë aktakuzës dhe cilësimit juridik të dhënë në të .Gjatë këtij shtimi gjyqësorë patëm rastin ta dëgjojmë dëshmitarin Rr. B. i vili na bërë përshkrimin e natës kritike të dt. 22.6.2013 ku kishte hasur me këtu të pandehurit duke bërë ngarkimin e trungjeve të prere i cili ju kishte bërë me dije që ta bëjnë shkarkimin e tyre dhe të njëjti kishin premtuar se do ta bëjnë por të nesërmen në mëngjes kishte vërejtur se trungjet nuk kishin qenë aty . Sa i përket veprës së parë penale mendoj se gjithçka është e qartë sepse në shkresat e lëndës ka mjaft prova materiale të cilat e vërtetojnë se i pandehuri R. L. e ka kryer këtë vepër penale . Gjithashtu për veprën e dytë penale ka mjaft prova materiale ku shihet se është bërë prerja e trungjeve e cila është konstatuar menjëherë pasi që janë yenë nga dëshmitari B. andaj në tërësi mbes pranë aktakuzës njëkohësisht gjykatës i propozoj që të njëjtit ti shpalli fajtori dhe ti dënoj sipas ligjit dhe ti obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

**I pandehuri R. L.:**

Sa i përket veprës së parë penale ndihem fajtorë që nuk e kam pas fletë përcjellësen me vete përkatësisht dokumentin mbi prerjen edhe pse trungjet i kam prerë në pronën time – por prapë e pranoj se kam gabuar dhe me vjen shumë keq. Veprën e dytë penale nuk e pranoj sepse të njëjtën nuk e kam kryer dhe e lus gjykatën që për këtë vepër të më liroj nga aktakuza . Po ashtu lus gjykatën që për veprën e parë penale të më shqiptoj një dënim sa ma të butë që është e mundur sepse jam i gjendjes së rëndë ekonomike dhe jetojmë nga asistenca sociale . Ju betohem se në të ardhmen do të përpiqem shumë që të mos kryej kurrë vepra penale .

**I pandehuri J. N. :**

Nuk ndihem fajtorë për atë që më vihet në barrë . Ju betohem se nuk e kam kryer këtë vepër .Lus gjykatën që të më liroj nga aktakuza.

**I pandehuri B. N.:**

Nuk e kam kryer veprën penale e cila më vihet në barrë . Kurrë në jetën time nuk jam marrë me kësi punë. Lus gjykatën që të më liroj nga aktakuza

**Mbrojtësi i të pandehurit M.N. av. S. L.:**

Gjatë këtij shqyrtimi gjyqësore u vërtetua se i mbrojturi im M. N. nuk e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë dhe fillimisht kamë shpronësuar se prokurori shteti në mungesë së provave do të tërhiqet nga aktakuza mirëpo meqë i njëjti nuk e bëri atëherë e lus gjykatën që të mbrojturin tim ta liroj nga kjo aktakuzë , për arsye se pas administrimit të shkresave të lëndës gjithçka kemi vetëm një deklaratë të dëshmitarit –pylltarit B. e cila është mjaft kundërthënëse me vetveten dhe të cilës propozoj që të mos i fallet besimi e unë shpresoj se edhe gjykata nuk do ti besoj -meqë nuk kemi fotografi nga vendi i ngjarjes të ditën kritike , me që nuk janë bërë as matjet ditën kritike- në shkresat e lëndës ka foto nga një vend i prerjes për të cilat nuk dihet nga kanë ardhur, ku kanë prerë dhe kush ka prerë. Andaj bazuar në gjithë këtë në mungesë të provave dhe fakteve konsideroj se as gjykata nuk do të duhej që të shpallë këtë fajtori duke u bazuar vetëm në një deklaratë të një dëshmitari i cili punon në organizatën e dëmtuar. Kështu që e lus gjyqtarin që të mbrojturin tim ta liroj nga aktakuza .

**I pandehuri M. N.:**

E përkrah dhe e përmbaj në tërësi fjalën e mbrojtësit tim dhe nuk kam se çka të shtoj tjetër.

**Duke e shqyrtuar dhe analizuar me shumë kujdes gjithë atë që është thënë, që është dëgjuar dhe lexuar gjatë shqyrtimit gjyqësorë gjyqtari ka konstatuar :**

Sa i përket pikës I të dispozitivit të aktakuzës përkatësisht veprës së parë penale të dt. 13.6.2013 me të cilën ngarkohet i pandehurit R. L. gjyqtari ka konstatuar se i pandehuri e ka kryer këtë veprë penale: ky konstatim i gjyqtarit del: nga pranimi i pjesërishëm i të pandehurit se trungjet vërtet i ka prerë por në malin e tij privat por edhe nga deponimi i dëshmitarit Rr. B. e në veçanti nga fotografitë të cilat janë bërë në vendin ku është zënë i pandehurit R. me Kamionin Man dhe trungjet e ngarkuara ne te – të cilat janë konfiskuar aty për aty!.

Sa i përket pilës II të dispozitivit të aktakuzës gjyqtari nuk është bindur për fajësinë e të pandehurve përkatësisht nga provat e nxjerra nuk është konstatuar përkatësisht nuk është provuar se të akuzuarit e kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar- atë të dt. 22.6.2013 .

Gjyqtari e ka dëgjuar me vëmendje dëshmitarin e vetëm Rr. B. – pylltar pranë APK-së i cili ka thënë se ... i ka zënë të pandehurit –që të katërtit duke ngarkuar trungje në kamion ... dhe se pastaj të nesërmen ka shkuar dhe e ka konstatuar edhe fotografuar vendin e prerjes ... mirëpo pylltari po ashtu ka thënë se një natën më parë kur i ka zënë të pandehurit duke i ngarkuar trungjet në kamion “fotoaparati nuk i ka punuar”, “se atë natë nuk e ka bërë matjen e trungjeve” si dhe “nuk e ka ftuar policinë për ti konfiskuar trungjet” .

Prova të tjera –veç deklaratës së dëshmitarit B. nuk ka pasur-ndërkohë që gjyqtarit nuk i ka mjaftuar një provë e vetme për të shpallur fajtor të pandehurit nga se neni 262 i KPPRK-së është decidiv : “ gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtorë duke u mbështetur vetëm në një dëshmi , ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie apo një prove tjetër ... gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një deklaratë...”

Në rastin konkret për veprën penale të dt. 22.6.2013 për të cilën akuzohen katër të pandehurit përveç dëshmisë së dëshmitarit B. prova tjera nuk ka pasur, ndërkohë që edhe kjo dëshmi është mjaft e mangët , sepse :

Si është e mundur që dëshmitarit “mbrëmjen kritike të mos i punoj fotoaparati, si është e mundur që ai të mos e ketë bërë matjen e trungjeve , dhe akoma ma interesant është fakti se “si bënë që të mos ftohet policia në raste të tilla” – ndërkohë që vet dëshmitari tha se “ai është i obliguar që rastet si ky ta njoftoj dhe ta thërras policinë! .

Në raste të këtilla gjyqtari e ka vetëm një mundësi dhe atë të veproj konforom nenit 3 par 2 të KPPRK-së ku shkruan : “mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij kodi dhe sipas kushtetues të Republikës të Kosovës”

Në favor të të pandehurve ka vendosur gjyqtari duke qenë i bindur se me një provë të vetme dhe me mëdyshje nuk është e drejtë të shpallet fajtor dikush, kështu është vendosur edhe për faktin se normat e vjetra juridike përkatësisht parimet botërisht të njohura të botës demokratike në lëmin juridiko penale që e kanë për djep romen e lashtë përcaktojnë : “ më mirë është që 100 fajtorë të lirohen , se sa një i pafajshëm të shpallet fajtor .

Nga sa u tha më lartë , u vendos si në dispozitivin e aktgjykimit .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësorë është marrë konform nenit 453 par 4 dhe 454 të KPPRK-së

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës në kontestin e rregullt civil është marrë konform nenit 463 të KPPRK-së .

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë.17.6.2015

Sekretarja juridike  
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari  
Sejdi Blakaj

**KËSHILLA JURIDIKE**

Kundër këtij aktgjykimi lejohet  
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga  
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë  
E përmes kësaj Gjykate .